

RAPORTI VJETOR 2016



Përgatiti:
Znj. Teuta Shkenza
Drejtore Nacional
SOS Fshatrat e Fëmijëve
Shqipëri

Tabela e Përmbajtjes

Përmbledhje e Punës së Shoqatës Nacionale për vitin e raportuar	3
1. Një Fëmijë	4
1.1 Kujdesi me Bazë Familjen	4
1.2 Fuqizimi i Familjes	5
1.3 Advokasia	6
2. NJË MIK – Të rrisim numrin e Miqve SOS në botë për të financuar 1150 fëmijë	7
2.1 Të ardhurat kesh	8
2.2 Fondet Publike.....	8
2.2 Donacionet në natyrë.....	8
3. Një lëvizje – Njerëz të Fortë, Shoqatë e Fortë.....	9
Kalendari i eventeve kryesore për vitin në vazhdim.....	10
Anëtarët e Bordit të Shoqatës.....	11
4. Programi i SOS Fshatrat e Fëmijëve Tiranë.....	12
4.1 SOS Fshati i Fëmijëve.....	12
4.2 Komunitet Youth Facilities	15
4.3 Arritjet kryesore të 2016, praktikat e mira dhe sfidat në FSP	16
5. Programi i Fuqizimit të Familjes Shkodër.....	18
Histori suksesi	20

Përmbledhje e Punës së Shoqatës Nacionale për vitin e raportuar

Shqipërisë iu dha Statusi i Vendit kandidat nga Këshilli i Europës në vitin 2014. Marrveshja e Stabilizim Asocimit është në fuqi që prej prillit të vitit 2009 dhe Shqipëria i ka zbatuar me ngadalë detyrimet e saj. Shqipëria ka vijuar të ketë dialoge të rregullta politike dhe ekonomike me BE-në nëpërmjet strukturave përkatëse sipas MSA-së. Qeveria është angazhuar në reformat e lidhura me BE-në dhe vazhdon të bëjë progres në plotësimin e objektivave të vendosur në pesë prioritetet kyçe për hapjen e negociatave. Shqipëria vazhdon të ketë rol konstruktiv dhe proaktiv në bashkëpunimin rajonal dhe mban fqinjësi të mirë siç është angazhuar në Marrveshjen e Stabilizim Asociimit.

Kuadri ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është në linjë me standardet Europiane. Shqipëria ka ratifikuar pjesën më të madhe të konventave ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Megjithatë, mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut duhen fuqizuar ende.

Shqipëria ka bërë disa përgatitje për sa u përket politikave sociale dhe punësimit. Progres është bërë edhe me disa ndryshime të dukshme të kodit të punës dhe ligjit për ndihmën ekonomike, strategjisë së mbrojtjes sociale dhe politikës së shëndetit dhe sigurisë 2016-2020 dhe plan veprimit të saj. Po ashtu ka filluar implementimi i strategjisë së aftësive dhe punëve në vend. Shkalla e punësimit dhe tregu i punës mbeten të ulëta dhe ekonomia informale mbetet një faktor kyç në ofrimin e punësimit.

Ndryshimet në Kodin e Punës hynë në fuqi në qershor të vitit 2016. Ligji i ri ka për qëllim të fusë disa direktiva të BE-së që kanë të bëjnë me mos diskriminimin në punë, të drejtat e prindërve dhe të drejtën për tu informuar, marrdhënien punëdhënës – punëmarrës dhe punën nga shtëpia. Po ashtu ky ligj ka rritur moshën minimale të punës nga 14 në 15 vjeç në linjë me Konventën Ndërkombëtare të Punës. Megjithatë parashikimet mbi punën e detyruar mbeten të paqarta dhe ligji nuk ofron sanksione në rast shkeljesh.

Shkalla e papunësisë sipas sondazheve të bëra ka rënë lehtë nga 17.5 % në 2014 në 17.1 % në 2015 por ajo mbetet ende e lartë veçanërisht tek gratë, të rinjtë dhe personat me aftësi ndryshe. Shkalla e papunësisë për burrat ka rënë nga 19.2% në vitin 2014 në 17.1% në 2015-ën ndërsa për femrat kjo shkallë është rritur nga 15.2% në 17.1%. Duhet të bëhet diçka për të ndryshuar sfidat në tregun e punës si papunësinë tek të rinjtë dhe informalitetin. Ligji mbi programet e nxitjes së punësimit ka përfunduar por mbetet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Për sa i përket mbrojtjes dhe përfshirjes sociale, janë adoptuar strategjia e re mbi mbrojtjen sociale dhe një dokument politikash për përfshirjen sociale 2015-2020. Të dy politikat përcaktojnë objektiva për të ulur varfërinë, për të monitoruar politikat e përfshirjes ndër sektoriale, duke vënë në jetë reforma në fushën e mos diskriminimit dhe vendosjen e sistemit të kujdesit social. Pjesa më e madhe e shërbimeve sociale mbeten të varura nga donatorët dhe u mungon buxheti i duhur. Shkalla e punësimit për Romët dhe Egjiptianët është e ulët ku pjesa më e madhe është në sektorin informal. Është adoptuar Strategjia Kombëtare për Strehimin 2016-2025. Puna e fëmijëve mbetet një shqetësim i madh ku përfshihen edhe ambientet e rrezikshme ku ata punojnë. Për të parandaluar punën e fëmijëve duhet të merren masa më efikase.

Për të drejtat e fëmijës, ka nisur të rishikohet ligji aktual për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ka nevojë të përmirësohen mekanizmat e mbledhjes së të dhënave dhe të raportimit në mbrojtjen e fëmijëve dhe të përmirësohen mekanizmat bashkëpunues ndër sektoriale dhe ndër-institucionalë.

Reforma territoriale pati një impakt jo të mirë në funksionimin e njësive për mbrojtjen e fëmijës për shkak të shkallës së lartë të lëvizjes së stafit, veçanërisht të stafit që ishte trajnuar për mbrojtjen e fëmijëve dhe numri i vogël i punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve për banorë, veçanërisht në zonat rurale.

Emigrimi i minorenëve të pashoqëruar nga Shqipëria për në vendet e BE-së ka mbetur një shqetësim serioz. Për tu marrë me këtë fenomen në tetor u ngrit një grup pune i cili do të rishikonte dhe legjislacionin. Midis periudhës mars 2015 – mars 2016 prokurorisë i janë referuar 18 raste keqtrajtimi ndaj minorenëve.

1. Një Fëmijë

1.1 Kujdesi me Bazë Familjen

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri ka një eksperiencë të gjatë në kujdesin alternative dhe ka treguar angazhim ndaj kujdesit ndaj fëmijëve përmes: *20 viteve experience në shërbimet e Kujdesit me Bazë Familjen në familjet SOS, 15 vite në Kujdesin ndaj të Rinjve*. Kujdesi me Bazë Familjen është pjesë e Programit të Tiranës dhe përbëhet nga SOS Fshati i Fëmijëve i lidhur me dy komunitete rinore.

128 fëmijëve u është ofruar kujdes me bazë familjen përmes mbështetjes psiko-pedagogjike që u është dhënë nga SOS Nënate/Tezet/Asistentet e Familjes dhe stafi i zhvillimit të familjes. Në fund të vitit në SOS fshat është ofruar kujdes për 67 fëmijë, 27 të rinj në Komunitetet Rinore dhe 34 të rinj përmes Programit të Gjysmë pavarësisë dhe formave të tjera të paskujdesit. Këtë vit u pranuan 12 fëmijë të rinj (7 fëmijë ishin pjesë e institucionit shtetëror ku Avokati i Popullit kishte zbuluar fakte për dhunë dhe abuzim të fëmijëve në institucionin e kujdesit në Shkodër) dhe 9 të rinj arritën pavarësinë e plotë duke treguar aftësi për tu kujdesur për veten dhe 8 nga ata u ribashkuan me familjet e origjinës. *Shfrytëzimi i kapaciteteve të SOS Fshatrat e Fëmijëve Tiranë ka qënë në shkallën 79.2%.*

Përmes projektit Familja e para, SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri vlerësoi dhe rishqyrtoi ndryshimet në jetën e SOS Fshatit e fëmijëve Tiranë me qëllim zhvendosjen drejt një përqsaje të tipit familje. Stafi (470) i SOS fshatit u bë pjesë e procesit të reflektimit përmes seminareve të detajuar dhe diskutimeve të frytshme dhe nga procesi me ta, me fëmijët dhe të rinjtë dolën rekomandimet përkatëse. Për reflektimet u përdorën disa lloje metodologjish në mënyrë që informacioni i mbledhur të ishte sa më i dobishëm dhe i sinqertë. Deri tani, pjesa më e madhe e rekomandimeve janë për:

- i. Kujdesin ndaj Fëmijëve (përshembull ndryshimin e numrit të fëmijëve për familje); Burimet Njerëzore (rritjen e numrit të tezeve dhe të asistenteve të familjes për shtëpi)
- ii. Financën dhe Buxhetin (proces shumë i përqëndruar dhe jo nën administrimin e SOS nënës. Pjesa më e madhe e pagesave janë organizuar nga administrate, shumë procedura),
- iii. Administrata (bërja e pazarit në mënyrë të organizuar duhet të shmanget dhe familjeve duhet tu jepet më shumë mundësi; të gjitha strukturat, fshati, ZN dhe programi në një lokacion bëjnë që ambjenti të duket më shumë si institucion se sa si familje) dhe çeshtje të tjera (për shembull, heqja e logos, reduktimi i vizitave të donatorëve dhe jo shumë publicitet).

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, gjatë këtij viti ka theksuar nevojën për të përshpejtuar procedurat e nisura tashmë për *de-institucionalizim*. Për këtë qëllim, do të ngrihet një grup ekspertësh të cilët do të punojnë në institucione publike për të kryer këtë proces. SOS-i tashmë ka filluar të jetë pjesë e procesit përmes implementimit të aksion planit të De-I në institucionin e kujdesit publik në Tiranë (financuar nga SOS Hollanda) dhe përmes një projekti që ka filluar kohët e fundit në bashkinë e Shkodrës (me fondet e Save the Children) që fokusohet në forcimin e kapaciteteve të bashkisë për sa u përket shërbimeve për të parandaluar institucionalizimin dhe fillimin e integritit të fëmijëve nga institucionet e kujdesit shtetëror në familjet e origjinës.

Bashkë me Burimet Njerëzore është përgatitur një aksion plan për futjen e SOS çifteve. Duke integruar çiftet, SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri do të zhvillojë më tej sistemin e punës sociale në Fshatrat e fëmijëve duke respektuar parimet e kujdesit me bazë familjen dhe standardet e cilësisë për shërbimet sociale të ofruara. *Për momentin ne po hasim disa vështirësi në aspektin ligjor të prezantuarit dhe mbështeturit të SOS prindit tek shërbimi social shtetëror dhe për këtë janë marrë hapa të ndryshme si: takime me avokatin e organizatës për më tepër sqarime, takime me shërbimin social shtetëror në Bashkinë e Tiranës etj.*

Implementimi i qasjes së menaxhimit të rastit në KBF do të aplikohet vitin tjetër për shkak të disa ndryshimeve të rëndësishme në strukturën organizative të Programit të Tiranës (Lider i KBF-së dhe Drejtuesi i Departamentit të Zhvillimit të Fëmijës dhe Familjes). Të gjitha mjetet u ofruan nga SOS Kosova të përkthyer në shqip për të reduktuar koston. Për implementimin e menaxhimit të rastit në KBF do të merren hapa të tjerë bazuar në aksion planin e përgatitur nga ekipi.

Baza e të dhenave të KBF mbetet një mjet i rëndësishëm për punonjësit e Kujdesit me Bazë Familjen. 90% e fëmijëve dhe të rinjve aktiv janë pjesë e bazës së të dhënave të Programit. Punonjësit marrin trajnime

rifreskuese për këtë gjë. Në të ardhmen, fokusi duhet të jete më tepër në përditësimin e rregullt të të dhënave të fëmijëve dhe të rinjve në sistem dhe në përdormin e këtyre të dhënave për planifikim, monitorim dhe raportim.

Punësimi i të rinjve mbetet një nga prioritetet kryesore të punës sonë. SOS Shqipëria ka marrë iniciativa të mira përsa i përket punësimit të të rinjve përmes rritjes së aftësive për punë të tyre. 17 studentë Universiteti kombinojnë studimet me punën (me kohë të pjeshme dhe të plotë) dhe rreth 94% e të rinjve në programin e ½ pavarësisë punojnë. Bashkëpunimi me departamentin e Ngritjes së Fondeve është forcuar me gjetjen e punësimit në kompani të ndryshme apo përmes programeve të praktikës.

Sipas strategjisë afatgjatë të SOS Shqipërisë, qëllimi është që Fshati SOS të njohet si ofrues i shërbimit të kujdestarisë dhe po ashtu fushata Kujdesu për Mua, ka aksione që lidhen me ndryshimin e politikave për njohjen e kujdesit profesional dhe formave të tjera të shërbimit të kujdestarisë. Njohja *si ofrues i shërbimit të kujdestarisë* mbetet prioritet. Janë organizuar takime të ndryshme me qeverinë lokale dhe qëndrore për të gjetur mundësira për këtë njohje. Modeli SOS i Shërbimit të Kujdestarisë është një mundësi për të rritur burimet financiare shtetërore në prespektivën afatgjatë të SOS Shqipërisë.

1.2 Fuqizimi i Familjes

Programi i Fuqizimit të Familjes me më tepër se 12 vite eksperiencë në mbështetjen e fëmijëve dhe familjeve në nevojë, është një nga programet kryesore që SOS Shqipëria implementon me sukses. Mund të flasim këtu për *751 fëmijë dhe të rinj e 268 familje që janë mbështetur deri në 31 dhjetor 2016. 67 nga 68 familje (98.5%) e kanë lenë projektin si të suksesshme* pasi kanë arritur objektivat e planit të zhvillimit të familjes gjatë vitit, ndërkohë që një tjetër familje ka dalë nga projekti për arsye të tjera.

Momentet kryesore të 2016

Bazuar në rezultatet e mira të punës së bërë në vitin e parë, ne arritëm të shtynim kontratën që kemi me ANTEA CEMENT sh.a edhe për një vit tjetër, për të ofruar shërbime sociale në zonat rurale të Thumanës dhe Borizanës. Buxheti total që ka dhënë kompania është **28,177 Euro**.

- ⇒ Numri i pjesëmarrësve në program është ulur disi për 2016 me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe reduktimin e raportit staf-përfitues
- ⇒ Programi i Fuqizimit të Familjes (manuali për rritjen e kapaciteteve prindërore) u implementua për të gjithë Projektet e Fuqizimit të Familjes dhe rezultatet ishin vërtetë të mahnitshme. Kujdesdhënësit dhe fëmijët kanë shprehur vlerësimin e tyre të lartë për këtë metodë të re pune mbi ndërtimin dhe rifuqizimin e komunikimit në familjen e tyre dhe mënyrën e zgjidhjes së problemeve ndërmjet pjestarëve të familjes.
- ⇒ Shtylla e Fuqizimit të Familjes në Bazën e të Dhënave të Programit është përdorur rregullisht nga punonjësit gjatë gjithë vitit duke zgjeruar proceset e monitorimit dhe vlerësimit në nivel programi dhe nivel nacional.
- ⇒ Fuqizimi i Familjes Shkoder është duke implementuar projektin “Të përmirësojmë sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri”. Ky projekt filloi në 1 mars 2016 në bazë të një marrveshje bashkëpunimi trepalëshe ndërmjet Save the Children, SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri dhe Bashkisë Shkodër. Projekti mbështeti 54 fëmijë (23 familje).
- ⇒ Një nga punonjëset e projektit të Fuqizimit të Familjes Sauk u promovua si Drejtuese e Zhvillimit të Fëmijës dhe Familjes në Programin e Tiranës dhe në vend të saj u rekrutua një punonjëse e re sociale.
- ⇒ Projekti i Fuqizimit të Familjes Sauk, punoi me rregullimin e ambjenteve të tij për ti përshtatur dhe organizuar në mënyrë të tillë që të plotësonin nevojat e fëmijës dhe familjes dhe po ashtu të grupeve. Puna intensive dhe e përkushtuar e punonjësve ka sjellë në projekt një ambient të ngrohtë për fëmijët dhe familjet.
- ⇒ Projekti i Fuqizimit të Familjes Shkoder konsiderohet si një partnerë me eksperiencë në rastet e parandalimit të braktisjes së fëmijës. Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës ka qënë pjesë e grupit multidisiplinar në të gjithë takimet dhe tryezat e rumbullakta të organizuara për rastet e fëmijëve në rrezik, raportuar nga projekti.
- ⇒ Në kuadër të fushatës globale “Zëri i të Rinjve – E ardhmja që duam” u formua Grupi i të Rinjve me të rinj nga programi i Fuqizimit të Familjes në Shkodër dhe institucioni rezidencial (6-18 vjeç)
- ⇒ Përmes aksioneve konkrete të advokatisë nga punonjësit e Fuqizimit të familjes, u bë e mundur regjistrimi për herë të parë i 16 të rinjve në çerdhe dhe kopështe pa pagesë.

⇒ Për 30 familje, pjesë e shërbimeve tona, pas orjentimit dhe plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, u bë e mundur përfitimi i programit të strehimit në Tiranë.

Brenda 12 viteve aktivitet, programi i Fuqizimit të Familjes ka rritur, u ka dhënë dhe ka diversifikuar shërbimet e tij më tej për të përmbushur më mirë nevojat individuale të fëmijëve/të rinjve dhe familjeve. Për 2016-ën ne mund të nënvizojmë rrezultatet e shërbimeve si më poshtë:

(i) mund të flasim për më tepër se 80 % të fëmijëve pjesmarrës që mbështeten me shërbime të ndryshme edukative.

(ii) Bazuar në bazën e të dhënave të programit, 91, 9 % e fëmijëve marrin shërbime shëndetësore dhe mesatarisht 70% e tyre kanë përmirësuar situatën shëndetësore.

(iii) Mesatarisht, më tepër se 85 % e fëmijëve dhe kujdesdhënësve përfitojnë nga shërbimet psiko-sociale dhe më shumë se 60% e tyre e kanë përmirësuar mirëqënien psiko-sociale. Politika e Mbrojtjes së Fëmijës ka qënë pjesë e trajnimeve tona me fëmijët dhe me kujdesdhënësit.

(iv) Logopedisti është tani i njohur dhe i mirëintegruar për fëmijët por gjithashtu duke mbështetur kujdesdhënësit se si të punojnë me metoda dhe materiale të thjeshta me fëmijët.

Praktikat pozitive kryesore të Fuqizimit të Familjes që mund të përmendim për 2016 janë:

(i) Krijimi i modeleve/shembujve pozitivë të familjeve të fuqizuara ka inkurajuar të tjera familje të përmirësojnë jetesën e tyre. (ii) Klubi i Baballarëve është një eksperiencë unike pozitive për kujdesdhënësit meshkuj që të socializohen me njëri-tjetrin. (iii) Staf i Fuqizimit të familjes merr pjesë aktive në tryezat e rumbullakta të mbrojtjes së fëmijëve për raste abuzimi ku përgjegjësitë ndahen ndërmjet partnerëve duke rritur kështu profiling e organizatës si ofrues shërbimesh në komunitet. (iv) Puna me riintegrimin e fëmijës si pjesë e procesit të De-I në vend.

Sfidat

(i) Familjet që riintegrohen nga emigrime të tjera, hasin shumë vështirësi dhe ne kemi nevojë për përpjekje me të forta dhe mbështetje më të mirë financiare për të punuar me ta. (ii) Përkeqësimi i situatës së biznesit në vend, ka ulur burimet e financimit dhe llojet e tjerë të mbështetjes për target grupet tona. (iii) trajnimet profesionale për kujdesdhënësit kanë rritur aftësitë e tyre për të mbajtur punët (më koëh të plotë apo të pjesshmë (iv) Megjithë përpjekjet e bëra gjatë vitit Baza e të Dhënave të programit ka nevojë për përdorim të përditshëm.

1.3 Advokasia

Gjatë vitit 2016, me kontributin dinamik të Departamentit të Zhvillimit të Programit, advokasia ka qënë factor në zhvillime të rëndësishme sociale në vend. Është e rëndësishme të theksohet fakti se SOS Shqipëria ka qënë pjesë e konsultimeve dhe ka kontribut të madh për zhvillime të ndryshme të politikave sociale në institucionet më të larta legjislativë në vend (komisionet parlamentare). Nga ana tjetër advokasia ka kontribuar në mënyrë aktive në procesin e planeve dhe strategjive të ndikimit në nivel qendror e lokal. Aksionet e advokasisë janë kryer nën 3 shtylla kryesore: fushata "Kujdesu për Mua"; projekti "Zëri i të Rinjve" mbështetur nga UNFPA; ndjekja e fushatës "Unë Vlejt".

- Kontributi dhe pjesmarrja në 'Nën komisionin për Çështjet e të Rinjve, Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje' në maj 2017 gjatë seancës dëgjimore publike për "Të drejtat e fëmijëve kundër dhunës dhe abuzimit – një fokus mbi rastet e fundit të dhunës në qendrat rezidenciale për fëmijët" me përfaqësues nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe organizata të shoqërisë civile.
- Në shtator 2016, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë organizoi konsultime me organizata të shoqërisë civile në lidhje me "Axhendën kombëtare të të drejtave të fëmijëve 2016-2020". SOS Shqipëria ka dhënë kontribut dhe opinionet e saj për tema si kujdesi alternativ (veçanërisht shërbimi i kujdestarisë dhe çështjet mbi daljen nga kujdesi) për tu marrë parasysh dhe të bëheshin pjesë e axhendës. Pjesa më e madhe e opinionëve tona u futën në dokument dhe u bënë pjesë e axhendës.
- Opinionet, bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile dhe advokasia në seancat dëgjimore konsultuese për "projektiligjin mbi Shërbimet e Kujdesit Social në Republikën e Shqipërisë" në Komisionin për Punësimin, Çështjet Sociale dhe Shëndetin", tetor 2016. SOS Shqipëria reflektoi në këtë projektligj çështjet e saj kryesore të advokasisë.
- Pjesëmarrja në konsultime për "Buxhetin e Projektit të vitit 2017" në "Komisionin për Punësim, Çështje Sociale dhe Shëndetësi" në nëntor 2016. Inputi për rritjen e buxhetit të shtetit për çështjet e fëmijëve me fokus fëmijët dhe të rinjtë pa kujdes prindëror. Sugjerime të ofruara nga SOS Albania në konsultim publik për buxhetin e shtetit shqiptar për arsim dhe shërbime për fëmijë dhe të rinj, të organizuar nga CRCA, Ministria e Arsimit, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë..

- Kontributi në hartimin e rezolutës dhe opinionet e rinisë sonë në "Seancën Dëgjimore për Rininë në Republikën e Shqipërisë", organizuar nga "Nën-komisioni për Çështjet e të Miturve, Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje", dhjetor 2016. Të rinjtë tanë paraqitën shqetësimet dhe sugjerimet e tyre komisionit për përmirësim.
- Në dhjetor 2016, bashkëpunim produktiv ndërmjet avokimit dhe ngritjes së fondeve për promovimin e fushatës C4M. Në sezonin e kartolinave, Zyra e Kryeministrit bleu / urdhëroi 700 kartolina nga SOS Shqipëria me logon e fushatës C4M. Nëpërmjet këtyre kartolinave Kryeministri, Zëvendës Kryeministri dhe 3 Ministrat Shtetëror pa portofol dërguan urimet e tyre.
- SOS Shqipëria është një nga aktorët kryesorë të implementimit të plan veprimit të DE-I në vend. Me një ekspert të jashtëm të UNICEF-it i cili ka mbështetur përgatitjen e planit të veprimit ka pasur bashkëpunim të vazhdueshëm dhe janë kryer takimet individuale. Janë dhënë të dhëna lidhur me kujdesin e përkujdesjes dhe largimin e shërbimeve të kujdesit dhe kontributi ynë është reflektuar në planin kombëtar të veprimit për shërbimet e fëmijës dhe familjes së MMSR.
- Takim me stafin e platformës online të ChildHub ku u pasqyruan dhe u diskutuan tema të fushatës Kujdesu për Mua.
- "Agjencia Shtetërore e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve" organizoi Planin Kombëtar të Mobilizimit me moton "Unë mbroj Fëmijët" gjatë muajve mars-qershor 2016. Në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve - më 20 nëntor, për një javë u organizua Java e të Drejtave të Fëmijëve nga kjo Agjenci në bashkëpunim me OShC. SOS Shqipëria ishte pjesë e Planit Kombëtar dhe u bashkua këtyre iniciativave kombëtare me veprime konkrete për të drejtat e fëmijëve.
- Në dhjetor SOS Shqipëria bëri një prezantim të quajtur "Përfshirja e Rinisë në Advokasi" në një seminar të Projektit të Zërave të Bashkuar për Fëmijët dhe Koalicioneve për Fëmijët në të gjithë rajonin zhvilluar në Tiranë – duke ndarë praktikën e mira me mbështetjen e BKTF.
- Të rinjtë e lokacioneve Thumanë dhe Shkodër organizuan dhe morën pjesë në projektin "Zëri i të rinjve" mbështetur nga UNFPA. Nëpërmjet kësaj fushate kombëtare, të rinjtë rritën aftësitë e tyre në vullnetarizëm, të drejtat e fëmijëve / të rinjve, ditët ndërkombëtare, rrjetin dhe avokimin për të drejtat e tyre etj. Praktikën e të rinjve kanë fituar aftësi duke mobilizuar dhe rritur ndërgjegjësimin për bashkëmoshatarët e tyre; Ata informuan komunitetin e tyre, organizuan animacione dhe aktivitete në natyrë me fëmijët në Shtëpinë e Fëmijës Shkodër, duke sensibilizuar dhe duke bashkëpunuar me institucionet publike (institucionet e kujdesit shëndetësor, shkollat fillore, shkollat e mesme, njësitë administrative etj.) duke bashkëpunuar në rrjet me të rinjtë e shoqërisë civile, duke organizuar evente të cilat u transmetuan nga TV lokale, advokuan për të drejtat e tyre në organet më të larta lokale si Kryetari i Bashkisë së Shkodrës. Në këtë fushatë kanë marrë pjesë dhe kanë përfituar drejtpërsëdrejti 103 të rinj, 71 të rritur / prindër dhe 25 fëmijë, ndërsa 390 të rritur dhe të rinj kanë qënë përfitues indirekt.

2. NJË MIK – Të rrisim numrin e Miqve SOS në botë për të financuar 1150 fëmijë

SOS Shqipëria po punon fort për të ngritur fonde lokale. Çdo ditë ne jemi duke ndërtuar marrdhënie të forta me kompani në mënyrë që t'i bëjmë ata donator. Nga ana tjetër ne po punojmë për të mbajtur donatorët aktualë për një marrdhënie sa më afatgjatë.

Ne kemi ende Miqtë, Mbështetësit dhe partnerët tanë dhe këtë ne e konsiderojmë si një nga sukseset më të mëdha duke parë se sa sfidë është kjo në Shqipëri.

Nga ana tjetër ne po punojmë për të pasur më shumë Mbështetës dhe Partnerë dhe në këtë prespektivë jemi të lumtur të themi se tani kemi dy Partnerë të Mëdhenj të cilët na mbështesin dhe ne duam të krijojmë një marrdhënie afatgjatë me ta.

Në tetor ne organizuam 20 vjetorin e shoqatës dhe ftuam të gjithë donatorët tanë të cilët panë 20 vitë të punës sonë dhe që të rinjtë tanë kishin krijuar jetët dhe familjet e tyre.

Këtë vit, sëbashku me një nga Mbështetësit tanë, ne organizuam një Fushatë në Rrjetet Sociale e cila ishte e suksesshme për të dy ne.

Si sukses në konsiderojmë gjithashtu vitin tonë të tretë të bashkëpunimit me Ambasadën Austriake dhe Teatrin e Operas dhe Baletit për një event për ngritjen e fondeve.

Puna jonë me Fushatën e Kartolinave po ecën ende mirë dhe kjo na gëzon. Nëpërmjet kësaj fushate ne mundëm të shpërndanim mesazhin e fushatës “Kujdesu për mua” me anë të kartolinave të porositura nga Kryeministri dhe disa Ministra në Shqipëri.

Antea Cement, kompania e madhe greke që hapi një projekt të ri për fuqizimin e familjes në partneritet me SOS Shqipërinë, për të mbështetur komunitetin ku ndodhet biznesi i tyre, vendosi ta shtyjë projektin dhe për një vit tjetër. Vlera e kontratës do të jetë 28.177 Euro.

Jemi te lumtur të themi se kemi dy partnerë të cilët na mbështesin përmes Paketave Familjare, 7560 Euro secili dhe gjithashtu shumë miq e mbështetës të tjerë të cilët na mbështesin përmes Paketave për Fëmijët. Në total kemi 35 fëmijë që mbështeten me Paketat për Fëmijë dhe ato Familjare.

2.1 Të ardhurat kesh

Për 2016-ën targeti ynë ishte 112.000 Euro (Ngritja e fondeve nga korporatat + fondet publike). Ne arritëm të realizonim të ardhura bruto prej 113.683 Euro që do të thotë 101.5% e targetit vjetor.

Këto të ardhura vinë nga:

➤ Rinovimi i marrveshjeve ekzistuese dhe evente:	2.845.024 ALL ose 20.800 Euro,
➤ Marrveshje të reja:	2.325.260 ALL ose 17.000 Euro
➤ Fushata e Kartolinave:	3.454.652 ALL ose 25.257 Euro
➤ Të tjera	1.845.435 ALL ose 13.492 Euro

2.2 Fondet Publike

Ne kemi aplikuar në total për 6 projekte & concept ide gjatë 2016-ës. Ky ka qënë një vit i begatë sepse bashkë me HGFD-në, SOS Shqipëria fitoi një projekt 3 vjeçar financuar nga BMZ (Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim)

- Bashkëpunimi, aplikimi dhe përfundimi i projektit “Të mbështesim sistemin e mbrojtjes së fëmijës në Shqipëri”, financuar nga Save the Children - 5,600 Euro
- Partneritet dhe bashkëpunim i vazhdueshëm me UNFPA; implementim dhe finalizim i projektit “Zëri i të Rinjve” - 5,100 Euro;
- Përfundimi me sukses i projektit një vjeçar në zonën e Thumanës dhe shtyrja për një vit tjetër/të dytë të projektit - Antea Cement - 28,177 Euro
- Zhvillimi, finalizimi dhe aplikimi i projektit 3 vjeçar të BMZ-së - 527.142 Euro (zbatimi ka filluar tashmë)

Pjesmarrje në nismën/aplikimi rajonal për BMZ dhe kontributi në përgatitjen e koncept idesë lidhur me Shërbimin e Kujdestarisë.

2.2 Donacionet në natyrë

Targeti vjetor për 2016 ishte 55,000 Euro dhe ne arritëm të ngrinim 5.015.312 ALL ose 36.667 Euro. Nga kjo shumë, pjesa që lehtësoi buxhetin ishte 4.631.374 ALL or 33.860 Euro që do të thotë 61% të targetit vjetor.

3. Një lëvizje – Njerëz të Fortë, Shoqatë e Fortë

2016-a ishte një tjetër vit kërkues për shoqatën tonë dhe po ashtu Burimet Njerëzore që kanë bërë çdo përpjekje për të ndihmuar në suksesin e përgjithshëm të organizatës duke ofruar mbështetje të vazhdueshme për menaxherët dhe stafin.

Indikatori Kyç i Performancës ka qënë pozitiv. Këtu mund të përmendim një lëvizje shumë të ulët të stafit, vetëm 2.6% si dhe një lëvizje të ulët të stafit kujdesdhënës në masën 4.4%.

Aktivitet kryesorë të zhvilluara gjatë vitit 2016 janë si më poshtë:

- **Numri i rekrutimeve** për vitin 2016 ishte 8. Përderisa organizata jonë ka për qëllim të promovojë dhe të mbajë punonjësit më të mirë, 2 nga rekrutimet, ai për Lider të Kujdesit me Bazë Familjen dhe Drejtues të Zhvillimit të Familjes dhe Fëmijës, u bënë të brendshme. Këto rekrutime u kryen në kuadër të riorganizimit të Programit të Fshatit.
Përveç këtyre, janë rekrutuar një Punonjës Social në Projektin e Fuqizimit të Familjes Sauk dhe 3 teze në SOS Fshat. Procesi i rekrutimit për tezet vazhdon gjatë gjithë vitit. Për këtë proces ne kemi kërkuar edhe bashkëpunimin e OJQ-ve të tjera të cilat kanë në fokus zhvillimin e grave dhe po ashtu kemi kërkuar bashkëpunim me zyrat e punës në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Po bashkëpunojmë edhe me Agjensi rekrutimi por pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme, të gjesh SOS Nëna dhe teze mbetet sfida. Po ashtu, për projektin e BMZ-së u rekrutuan Menaxherja e projektit dhe Asistentja e Financës dhe Administrative.
Përveç kesaj, vitin e kaluar u prezantua për herë të parë koncepti i SOS Çiftit. Ky hap do merret për të perfeksionuar kujdesin me bazë familjen që ofron SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri duke diversifikuar profilin e kujdesdhënësit. SOS Jifti i parë është rekrutuar në përputhje me standardet e brendshme të cilësisë dhe rregulloren e rekrutimit.
- **Zhvillimi dhe trajnimet e stafit**, kanë qënë si zakonsiht në fokusin e organizatës sonë edhe gjatë 2016-ës. Punonjësve u janë dhënë si trajnime të brendshme ashtu dhe të jashtme. Më kryesoret janë si më poshtë:
 - **Trajnime në grup: Nëna dhe Tezet** - “Komunikimi efektiv dhe Ndërtimi i grupit”; “Si të komunikojmë dhe të ndërtojmë marrdhënie me adoleshentët”, “Metoda pozitive për disiplinimin e fëmijës”. **Liderat Rinorë** – “Trajtimi rsateve të vështira dhe zgjidhjet alternative”. **Stafi menaxherial në nivele të ndryshme** – “Vlerësimi i riskut për OJQ-të. **Punonjësit Socialë** – “Përjasje të ndryshme për të rritur fondet lokale”, “Menaxhimi i riskut”
 - **Trajnime individuale:** “Ndërtimi i kapaciteteve për investigimet në lidhje me ruajtjen e fëmijës” në Bullgari,; “Fëmijët dhe të rinjtë me trauma, probleme psikologjike dhe të sjelljes në SOS kujdesin alternativ dhe mbështetja për kujdesdhënësit” në Vjenë.
- Rëndësi e vazhdueshme i është dhënë **bisedës së vlerësimit të performaces** dhe për ta kryer sa më mirë këtë proces, vitin e kaluar ne bëmë edhe një vlerësim të implementimit të sistemit të menaxhimit të performancës për **kujdesdhënësit**. Ky vlerësim tregoi që të gjithë Kujdesdhënësve u ishte bërë vlerësimi i performancës dhe në nivel organizate ky process është zhvilluar në masën 93.6%.
- **Angazhimi dhe mbajtja e stafit** është një nga objektivat kryesorë të organizatës. Përveç kushteve të punës, benefiteve, shpirtit të skuadrës dhe atmosferës që çdo punonjës gjen në SOS, paga është një faktor i rëndësishëm për të mbajtur dhe për të tërhequr një personel të kualifikuar i cili është shumë i rëndësishëm për suksesin e organizatës. Për këtë arsye, për 26 punonjës të cilët ishin nën kufijtë përkatës të pagave, u miratua **rritja e pagës**. Përveç kesaj, gjatë ceremonisë së 20 vjetorit të organizatës, punonjësve me më shumë se 10 vite experience iu dha një **çmim i dedikuar në Kristal**. Këtë motivim ne kemi për qëllim ta mbajmë vit pas viti.

Një sukses tjetër për tu përmendur për vitin 2016 ishte marrja e tapive të ndërtesave të SOS Fshatit dhe ulja e çmimit të energjisë duke kursyer rreth 1000 euro në muaj.

Kalendari i eventeve kryesore për vitin në vazhdim

Janar	<ul style="list-style-type: none"> - Organiimi i Bisedave të Vlerësimit të Performancës - Përgatitja për Vlerësimin e Shpejtë të Programeve - Rekrutimi i stafit të BMZ-së
Shkurt	<ul style="list-style-type: none"> - Takimi i Bordit - Auditi Financiar - Event për ngritjen e fondeve në bashkëpunim me Ambasadën Austriake dhe TOB
Mars	<ul style="list-style-type: none"> - Ceremonia e fillimit zyrtar të projektit të BMZ-së - Festa e Nënës - Trajnime
Prill	<ul style="list-style-type: none"> - Seminari për Vlerësimin e Shpejtë të Programeve - Ankand me piktura punuar nga fëmijët me artistë të famshëm - Vizitë në Shoqatën Promovuese dhe Mbështetëse
May	<ul style="list-style-type: none"> - Takimi i Bordit
June	<ul style="list-style-type: none"> - Asambleja e Përgjithshme - Festa e Fëmijëve në SOS Fshat - Dita e Donatorëve
July	<ul style="list-style-type: none"> - Takimi i Jashtëzakonshëm i Asamblesë së Përgjithshme të SOS Fshatrat e Fëmijëve Internacionale ku Shoqatat Anëtare, PSA dhe GSC do të firmosin marrëveshjen mbi planet afatmesme - Pushimet Verore të Fëmijëve
August	<ul style="list-style-type: none"> - Dita e Rinisë në Komunitetet Rinore - Përgatitja për Planifikimin Strategjik
September	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesmarrje e 2 SOS Nënave në Ceremoninë e Unazave organizuar në Kroaci - Takimi i Bordit - Përgatitja për Buxhetin 2018
October	<ul style="list-style-type: none"> - Takim i GNM - Planifikimi Strategjik
November	<ul style="list-style-type: none"> - Trajnime - Fushatë për ngritjen e Fondeve
December	<ul style="list-style-type: none"> - Fushata e kartolinave - Takimi i Bordit - Java e hapur në Programin e Tiranës

Anëtarët e Bordit të Shoqatës

SOS FSHATRAT E FËMIJËVE	SHQIPËRI	Data e përgatitjes	15.02.2017
--------------------------------	-----------------	---------------------------	-------------------

No.	Emri i anëtarit	Pozicioni
1	Mr. Tom Malvet	Përfaqësues i SOS KDI
2	Mr. Damir Coric	Përfaqësues i SOS KDI
3	Z. Mirush Bejko	President i Bordit
4	Z. Lulzim Kapllanaj	Zëvendës
5	Znj. Kreuza Lubonja	Anëtare
6	Znj. Silva Radovani Banushi	Anëtare
7	Znj. Lauresha Basha	Anëtare
Presidenti i Bordit		
Mr. Mirush Bejko		
Adresa:		
Rruga: "Muhamet Gjollesha"		
Tel. / Fax / e-mail:		
+355 69 20 20 718 mirush_bejko@yahoo.com		

4. Programi i SOS Fshatrat e Fëmijëve Tiranë

Programi i Tiranës ofron shërbime për target grupin tonë përmes FBC dhe FSP. Në FBC ne ofrojmë kujdes përmes SOS Fshatit si dhe kujdesit rinor në dy shtëpi familje. FSP-te tona ofrojnë kujdes në komunitetin Sauk, Don Bosko si dhe vitin që shkoi edhe në Thumanë përmes sponsorizimit nga ANTEA-CEMENT. Me këtë projekt marrin shërbime 19 familje në Thumanë dhe Borizane.

Në vitin 2016 u bë riorganizimi i të gjithë strukturës së Programit të Tiranës, e cila u shoqërua me një rindarje detyrash për shumë pozicione.

Në shtator 2016 u zgjodh lideri i ri i FBC, pozicion që mbahej nga CVPD. Gjithashtu u riorganizua gjithë mbështetja që i jepej fëmijës dhe familjes, në Departamentin e Zhvillimit të Fëmijës dhe Familjes dhe u rekrutua drejtuesi i këtij departamenti. Këtij riorganizimi u bashkëngjiti edhe implementimi i **Case Management** dhe të gjitha këto çuan në rishikimin dhe mirepërcaktimin e detyrave të secilit punonjës të stafit psikosocial. Ky rimodelim i organizimit të punës në Programin e Tiranës, solli dhe riorganizimin e Grupin Menaxherial të Programit të Tiranës. Në grupin menaxherial që drejtohet nga CVPD merr pjesë FBC lider, DDZHFF, kordinator FSP Sauk, kordinator FSP Donbosko si dhe financierja e Programit.

Gjatë 2016 zbriti në nivel programi dhe filloi implementimi i aksion planit nacional për **Family First**.

Mjediset e ish SOS kopshtit të Fëmijëve u pershaten dhe u vënë në funksion të fëmijëve për shërbime mbështetëse.

Godina e ish SOS kopshtit u rikonstruktua dhe u kthye në **Qendër Shërbimesh Sociale** për fëmijët dhe familjet e komunitetit.

Programi i Tiranës ka ngritur në nivel profesional marrëdhëniet e bashkëpunimit me njësitë administrative vendore, ku ne ofrojmë shërbime, si dhe me njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve në të gjithë vendin (sipas nevojave).

Bashkëpunimi mes njësive të Programit është periodik gjatë gjithë vitit. Burimet njerezore gjithashtu bashkërendojnë punët e tyre. Kemi psikologun e programit, financierin e Programit, punetoren e pastrimit, makinat dhe mjediset fizike, të cilat përdoren (salla takimesh, ëorkshopesh, trajnimesh) nga të gjitha njësitë e Programit.

Në datat 3-6 mars 2016, në pritim PSA. Gjatë 3 ditëve qëndrim këtu ata patën mundësinë të vizitonte nga afër shërbimet tona: kaluan kohë me të rinjtë tane në dy shtëpitë e rinisë, dhe konsumuan darkën bashkë me të. Mesuan për arritjet dhe dëshirat, si dhe planet e tyre në të ardhmen. Të nesërmen Kohën e drekës e kaluan në shtëpitë familje bashkë me fëmijët e kujdesdhenesit. Pas një perzantimi të shkurtër mbi FSP, miqtë vizituan nga afër 4 familje përfituesish në Sauk dhe 4 familje përfituesish në Don Bosko. Ditën e fundit i shoqëruam në Thumanë ku u njohën me Projektin atje duke vizituar perseri kater familje përfituesish.

Gjithashtu në muajin Tetor SOS Shqipëria celebroi 20 vjetorin e saj, ndaj u vizitua perseri nga PSA por edhe nga drejtori i programit të EUCB. Fokusi kryesor ishte vizita në të gjitha mjediset e shërbimit në Programin e Tiranës (FBC dhe FSP). Të rinjtë tane ishin promotorë të gjithë ceremonisë që u zhvillua për këtë rast.

4.1 SOS Fshati i Fëmijëve

Gjatë vitit 2016 në Kujdesin me Baze familjen janë ofruar shërbime dhe kujdes për 128 fëmijë dhe të rinj, nga 132 fëmijë, referuar Planit të Shfrytëzimit të Kapaciteteve 2016. Ky objektivi nuk është arritur për shkak të mos funksionimit si duhet të sistemit social shtetëror të referim-vlerësimit të rasteve. Ka filluar procesi i referimit të rasteve nga Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe vlerësimit të tyre nga Administratorët Social. Kështu megjithatë nga ana SOS Fshatit të Fëmijëve janë ndjekur procedurat e plota për vlerësimin dhe të 4 rasteve të tjera fëmijësh, nuk është mundësuar procesi final i vendosjes së tyre pranë kujdesit tonë përkrah për shkak të arsyes së lartpërmendur. Në nivel kombëtar ceshtja e vendosjes së fëmijëve në kujdes alternativ ngelet ende një prej sfidave të punës së Qeverisë Shqiptare. Po behen përpjekje për hartimin e standarteve dhe implementimin e formave të tjera si Foster Care por ende po ecet me hapa shumë të ngadalte.

Pranimet, transferimet, riunifikimet e fëmijëve në familje biologjike.

Viti 2016 startoi punen e tij vjetore për SOS Fshatin e Femijeve me 69 femije, nga të cilët 37 djem dhe 32 vajza. Gjatë vitit janë pranuar 12 femije të rinj, 11 në SOS Fshat dhe 1 i ri në Komunitetin Rinor. Si pasoje e publikimit në media të rasteve të dhunës në institucionet e kujdesit publik për femije, Ministra e Mireqenies dhe Sherbimi Social Shtetëror, ngriti TaskForcen dhe analizoi standartet e shërbimeve në të gjitha format e kujdesit alternativ. Shumë raste femijesh u referuan nga Sherbimi Social Shtetëror, prej të cilëve 7 femije u atashuan pranë fshatit SOS duke gjetur shërbime dhe kujdes me çelësor për rritjen dhe zhvillimin e tyre. Të gjithë femijet e rinj janë mbështetur në përputhje me nevojat që ata kanë paraqitur. Për shkak të transferimeve të femijeve në komunitetet rinore dhe riunifikimeve me familjet e tyre biologjike, numri i femijeve në fund të dhjetorit 2016 në SOS Fshat arriti në 67 femije.

Programi 12+ dhe transferimi i të rinjve

Programi 12+ dhe përgatitja e të rinjve për transferim, është një nga pikat tona më të forta e cila po konsolidohet vit pas viti. Gjatë këtij viti ka startuar për herë të parë implementimi i qëndrimit të femijeve në familjen SOS deri në moshën 18 vjeç, (një rast). Sfidë në këtë proces është forcimi i kapaciteteve të stafit kujdesdhënës dhe mbështetës, për t'iu përgjigjur implementimit sa më të butë dhe të sukseshëm të kësaj forme të re kujdesi. Janë transferuar **11 femije** në Komunitetet Rinore dhe **2 femije** të tjera janë mbështetur gjatë riunifikimit me familjet e tyre biologjike. Gjithashtu ka vazhduar mbështetja me plan pas kujdesi për 6 muaj edhe për **1 femije** tjetër, i cili është i atashuar para vitit 2016 në familjen e tij biologjike.

Procesi i planifikimit të zhvillimit individual të fëmijës tashmë është konsoliduar dhe realizohet mbi bazën e planifikimeve të qarta dhe rishikimeve të vazhdueshme. Çdo fëmijë që jeton në SOS FF, ka planin e tij individual të zhvillimit, i cili rishikohet 3 herë në vit. Numri i fëmijëve që kanë realizuar objektivat e PIZH ka ardhur **në rritje** për arsye se;

- Pjesëmarrja aktive e femijeve në takimet për PIZH është realizuar për çdo rast.
- Është fuqizuar roli i SOS nënave në gjithë procesin e PIZH
- Është rritur bashkëpunimi me shkollat e komunitetit dhe partneret që ofrojnë shërbime mbështetëse për fëmijet (sporti, gjuhët e huaja etj)

Për realizimin sa më të plotë të objektivave të përcaktuara në PIZH është ofruar një gamë e gjërë shërbimesh të specializuara si dhe mbështetje individuale rast pas rasti, e cila tashmë është praktikë e punës tonë. Ecuria e fëmijëve në këto shërbime monitorohet dhe vlerësohet nga ekipi multidisiplinar. Drejtimet kryesore të mbështetjes së fëmijëve kanë qënë; Edukimi, mbështetja psikologjike, promovimi dhe mbrojtja e të drejtave, përfshirja në veprimtaritë me karakter social, zhvillues, edukativ dhe argëtues.

Edukimi është siguruar nepermjet ndjekjes së arsimit parashkollor dhe atij shkollor në tre shkolla publike, një shkollë private dhe në një kopsht publik, në komunitet. Shërbimet kanë vazhduar pa shpëputje gjatë gjithë vitit shkollor dhe kanë qënë efektive. Të gjithë fëmijët kanë mbyllur me sukses vitin shkollor, 4 nga ata edhe provimet e lirisë. 15 fëmijë kanë arritur rezultate të larta në shkollë, ndërkohë që 3 fëmijë kanë arritur të lexojnë dhe 2 të tjerë kanë korrigjuar tingujt e artikuluar josaktë.

Sherbimi Psikologjik është pjesë shumë e rëndësishme e PIZH. Çdo femije në fshat ka vlerësimin psikologjik dhe bazuar në nevojat e tij hartohet një plan ndërhyrje. Shërbimet kryesore mbështetëse kanë qënë: mbështetje psiko-emocionale me keshillime individuale, vlerësime dhe terapi, nga ekspertë të jashtëm, mbështetje psiko-emocionale nga psikologja e programit, vlerësime dhe rivlerësime për PIZH dhe për transferimet në Komunitetet Rinore, seanca në grup, etj.

Cështja e Mbrojtjes së femijeve/ të rinjve ka qënë një nga prioritetet e punës në kujdesin ndaj femijeve jo vetëm për Organizatën SOS, por dhe për gjithë sistemin e ofrimit të shërbimeve në kujdesin alternativ. Sensibilizimi i fëmijëve, stafit mbështetës, partnerëve dhe komunitetit, për këtë çështje, ka qënë një ndër pikat e forta të punës tonë.

Gjatë vitit jemi fokusuar në këto drejtime:

Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të femijeve nepermjet realizimit të aktiviteteve dhe trajnimeve, si me fëmijet ashtu dhe me stafin, ku temat kryesore janë: Efektet e bulizimit në shkollë, Pasojat e dhunës tek

fëmijët, Menaxhimi i konflikteve në grup, Dhuna verbale dhe efektet psikologjike, Abuzimi seksual dhe pasojat psikologjike.

Parlamenti i femijeve ka qënë pjesëmarrës aktiv në trajtimin e të gjitha çështjeve dhe ka zhvilluar një aktivitet periodik gjatë gjithë vitit. Në kuadrin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve, ne periudhen 14-20 Nentor u organizua "Java për të drejtat e femijeve", në nivel programi dhe në bashkëpunim me partnerët.

Ne janar 2016, ne nivel Programi është diskutuar dhe plotësuar dhe CPP assessment tool 2015, për tu plotësuar më pas në nivel nacional. Ne perputhje me PMF, janë vlerësuar dhe ndjekur të gjitha hapat për rastet e incidententeve të ndodhura së brendshmi dhe së jashtmi.

Janë vlerësuar dhe ndjekur të gjitha hapat për tre raste të raportimit të dhunës. (Rasti i ndodhur në SOS familjen nr.6, nga SOS nënë B.LI ndaj fëmijës F.B, rasti i dhunës së ushtruar nga fëmija M.T ndaj fëmijës K.R dhe punonjëseve të pranishme në incident, si dhe rasti i pretenduar për ushtrim dhune i SOS nënës Xh.P ndaj fëmijës F.B. Në vlerësimin dhe ndjekjen në vazhdimësi të rasteve është reaguuar me profesionalizëm dhe është dhënë mbështetja e nevojshme për personat e përfshirë. Ne cdo rast kemi patur aksionet perkatese që janë ndjekur në vazhdimësi.

Gjatë muajit janar 2016 vazhdoi auditimi i System Based Audit in CV Tirana, i fokusuar në çështjet e zbatimit të PMF në SOS Fshat. Rezultatet u diskutuan në nivel Programi nga të gjithë pjesëmarrësit në auditim dhe në muajin qeshor u hartua Aksion-Plani me përfaqësues të Programit dhe në nivel nacional për realizimin e rekomandimeve të nxjerra nga ky auditim.

Ne muajin maj 2016, jemi audituar nga Task-force, e ngritur nga MPCS, mbi situatën e mbrojtjes së femijeve që jetojnë në kujdes alternativ. Rezultatet e këtij auditimi u bënë prezent nga auditorët po këtu muaj dhe kanë rezultuar pozitive me disa rekomandime për të cilat është punuar në vazhdimësi.

Ky vit ka patur larmishmëri **aktivitetesh të fokusuara** në problematikat e nevojave të femijeve dhe specifikat e tyre, në aspektin e zhvillimit akademik, social dhe emocional. Sfidë e punës tonë ka qënë zbehja gjithmone e me shume e tipareve institucionale edhe në këtë aspekt të rëndësishëm të shërbimeve që ne ofrojmë. Aktivitetet kanë qënë me karakter social, zhvillues, edukues dhe argëtues, Mbështetëse kanë qënë edhe veprimtaritë e organizuara me rastin e 20 Vjetorit të organizatës tonë, ku fëmijët/te rinjte ishin protagonistët kryesorë.

Veprimtaritë kryesore janë organizuar në nivel Programi gjë që ka qënë ndikuar pozitivisht në socializimin e fëmijëve dhe në integrimin më të mirë të tyre në komunitet.

Bashkëpunimi me partnerë si AIESEC, Miq për jete AD, Gjimnastika Kombëtare Aerobike, Fedarata e Sportit, Multiservice Center, Intersig, Pascucci, SFI, Irisoft ka ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, ka siguruar promovimin e talenteve tona nëpërmjet përfshirjes së gjere të femijeve në aktivitete dhe kompeticione mbarekombetare shpesh të finalizuara me marrjen e disa çmimeve dhe trofeve në këto perfaqesime.

Mirembajtja e kontakteve me prinderit biologjike dhe menaxhimi i tyre është realizuar me shume kujdes, bazuar në vlerësimin individual të secilit rast. **Disa nga veshitësitë kanë qënë;** marrëdhëniet e veshitë atashuese të disa rasteve me prinderit biologjike, raste prinderish me probleme të shëndetit mendor apo të stabilitetit emocional dhe prinder që vuajnë denimin, menaxhimi me kujdes i rasteve të fatkeqesive në familjet biologjike të femijeve, në menyre që femijet të kalojnë sa më lehtë traumën e humbjes së të afërmeve, mungesë interesi, në disa raste, nga prinderit/te afërmit dhe veshitësitë kontaktesh qofte edhe telefonike, mosrespektim i rregullores së takimeve.

Me gjithë veshitësitë e hasura, puna në ekip ka bërë që këto marrëdhënie të zhvillohen me kujdes dhe të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin dhe mirëqënien e fëmijëve.

Mbështetja dhe zhvillimi i stafit

Duke e vlerësuar stafin si aset më të rëndësishëm në shërbim të fëmijëve, mbështetja dhe zhvillimi i tij ka qënë në qendër të vëmendjes. Kështu SOS nënat/tezet dhe stafi tjetër mbështetës kanë marrë trajnimet e planifikuara në vazhdimësi sipas nevojave të paraqitura gjatë punës dhe Procesit të Vlerësimit të Performances. Me përparësi janë mbështetur dhe orientuar punonjëset e reja në detyrë për realizimin me sukses të misionit tonë. Gjithë stafi është mbështetur me specialiste supervizues, individualisht dhe në grup, në perputhje me dëshirat dhe nevojat e tyre, mbështetur në Standartet e SOS. Gjatë vitit është zhvilluar :

- Trajnimi me teme: "Menaxhimi i konflikteve nena - teze".
- Trajnim mbi disiplinën pozitive nga "Save the Children"
- Team building me stafin e Programit.
- Takimet orjentuese për "Case management", e cila u shoqërua dhe me riorganizimin e detyrave të stafit psiko-pedagogjik.

Si risi e këtij viti ka qenë përgatitja për implementimin e modelit të dhënies së kujdesit nga SOS cifti. Procedura ka startuar në nivel nacional dhe Kujdesi me Bazë familjen ka kontribuar në zbatimin e objektivave dhe detyrave të dhëna në përputhje me Planin e hartuar për këtë proces.

Procesi i vendosjes së fëmijëve nën **kujdesin ligjor të Organizatës** ka vazhduar në bashkëpunim me Shoqatën TLAS e cila ka ofruar shërbime falas dhe këtë vit.

Gjithsej janë ndjekur 9 raste fëmijësh gjatë vitit 2016, 5 prej tyre janë vendosur nën kujdestarinë ligjore të Organizatës. Njëri prej rasteve vazhdon të jetë ende në proces ndërsa 3 raste janë pushuar për arsye të ndryshme. Gjithashtu janë ndjekur procedurat për plotësimin e dosjes së plote të 1 rasti fëmijë i cili është në proces pranë Komitetit Shqiptar të Biresimit për tu biresuar në përputhje me ligjin Shqiptar. Ndërsa për 2 raste fëmijësh janë ndjekur procedurat dhe janë ende në proces legalizimi të pasurisë së tyre të cilën e kanë trashëguar nga familjarët e tyre biologjikë.

Status Quo - Në fund të muajit Dhjetor 2016 rezultoni: 9 fëmijë janë nën kujdestarinë ligjore të Organizatës, 3 fëmijë janë pa kujdestari (1 rast vazhdon të jetë në proces pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë), 55 fëmijë janë nën kujdestarinë ligjore të prindërve/te afërmeve.

4.2 Komunitet Youth Facilities

Programi i Tiranës vazhdon të ketë të njëjtin kapacitet për kujdesin e të rinjve në Komunitete Rinore. Në të dy komunitete rinore është ofruar kujdes dhe shërbime për 27 të rinj (13 Kr.1 dhe 14 Kr.3) në fund të muajit dhjetor 2016. Ndërsa në Programin e Gjysem Pavaresë dhe Programet e Paskujdesit janë ofruar shërbime për 33 të rinj (17 në Kr.1 dhe 16 në Kr.3) gjatë gjithë vitit, duke çuar kështu në 60 numrin e të rinjve të mbështetur në këto shërbime gjatë gjithë vitit. Gjatë vitit 2016, 12 fëmijë janë pranuar në të dy komunitetet rinore ku 11 janë transferuar nga SOS Fshati ndërsa 1 i ri është transferuar nga Shtëpia e Fëmijës "Zyber Hallulli" ku dhe është rikthyer perseri pas 3 muajsh. 5 të rinj të cilët ndiqeshin me Planin Paskujdesi janë shkeputur përfundimisht nga Kujdesi i Organizatës dhe janë riunifikuar në familjen biologjike, ndërsa 9 të rinj kanë dalë në Pavavaresë të plote. Gjithsej 14 të rinj janë shkeputur nga Programi i ½ Pavavaresë dhe forma të tjera të kujdesit në KR.

Të rinjtë tani të sukseshëm përfaqësojnë Organizatën nën aktivitetet dhe zhvillime të ndryshme të organizuara në nivel International. Edhe gjatë vitit 2016 objektivat e punës me të rinjtë janë fokusuar në çështje të cilat orientojnë dhe synojnë aftësimin e të rinjve drejt misionit final të Organizatës nepermjet:

*ofritimi të kujdesit cilësor për të rinjtë SOS

*orientimi dhe mbështetja për të rinjtë SOS drejt një profesioni

*mbështetja dhe orientimi e të rinjve në gjysem pavaresë

*mbështetja e të rinjve për gjetjen e një pune dhe ruajtjen e vendit të punës

*rritjes profesionale të stafit pedagogjik

*nxitjes dhe mbështetjen e të rinjve për sigurimin e bursave në universitetet publike

*rritjes së aftësive të të rinjve për mirë menaxhimin e të ardhurave etj etj

Të gjitha këto objektiva janë përkyer në arritje dhe zhvillime konkrete të të rinjve.

Edukimi. Gjatë vitit shumica e të rinjve në Komunitete Rinore ashtu dhe në Programe Gjysem Pavaresë dhe të Paskujdesit kanë ndjekur arsimin e detyrueshëm nëntë-vjeçar, atë të mesëm të përgjithshëm dhe profesional si dhe arsimin e lartë. Kështu 3 të rinj janë futur për herë të parë dhe kanë ndjekur studimet e mesme profesionale për IT pranë Shkolles "Herman Gmeiner", e cila tashmë është një shkollë e mesme publike profesionale. Gjithashtu 17 të rinj vazhdojnë studimet Universitare (2 prej tyre për herë të parë), ku një pjesë e tyre kanë mundur të fitojnë bursë gjysem apo të plote. Vlen të përmendet rasti i një të reje e cila ka arritur të fitojë të drejtën për të ndjekur studimet e simestrit të parë me bursë të plote në Portugali nepermjet aplikimit të Erasmus Plus. Të rinjtë që nuk kanë shfaqur arritje shumë të mira akademike janë mbështetur dhe janë orientuar drejt kurseve profesionale me qëllim marrjen e një profesioni.

Punësimi është një **sfiidë** e punës në Komunitete Rinore dhe megjithatë janë ndermarrë shumë inisiativa në punësimin e të rinjve si: *Regjistrimi i të rinjve në zyrtarët shtetërorë të punësimit; *Gjetja e mundësive për trajnime profesionale falas apo me cmime të ulta;

Punesimi i te rinjve ende vazhdon te sigurohet kryesisht nepermjet njohjeve personale te stafit. Keshtu 76% e te rinjve mbi 16 vjec si ne KR ashtu dhe ne SIL dhe Programe te tjera Paskujdesi kane pasur te pakten nje experience pune gjate vitit. Punet ne te cilat jane angazhuar si part time ashtu dhe full time jane kryesisht pune ne agjensi udhetime, qender internet, instalime elektike, rrobaqepesi, shitese etj.

Strehimi eshte i sigurt dhe mundesohet nga Organizata per te gjitha te rinjte . Kryesisht strehimi i te rinjve kete vit eshte mundesuar ne shtepi me qera apo vendosjen e te rinjve ne konvikte.

Arritje te veçanta, Aktivitete Advokuese. Gjate vitit te rinj te sukseshem kryesisht nga komuniteti rinor kane marre pjese disa here ne aktivitete dhe projektet advokuese brenda dhe jashte organizates dhe veprimtari per te drejtat e femijeve/te rinjve ku dy me kryesoret vecohen:

- Pjesmarrja e 4 te rejave SOS ne datat 1 deri 3 prill ne aktivitetin e zhvilluar ne Tirane me teme "Trajnim dhe Eorkshop per Advokacine" ne bashkepunim me Zyren Internacionale te SOS.
- Perfaqesim dinjitoz i te rese F.B. ne takimin planifikues per advokacine nga datat 6 dhe 7 Qershor te zhvilluar Insbruk Austri,
- Perfaqesim dinjitoz i te rejave M.Xh. dhe D.Zt ne Asamblene e Pergjithshme te SOS Internacional te Zhvilluar ne Insbruk me daten 25.06.2016,
- Pjesmarrje e te rese F. B. si perfaqesuese e te rinjeve te SOS Shqiperise ne takimin per temen "Standartet e cilesise per kujdesin ndaj te rinjeve" ne Insbruk Austri (ne datat 8 deri 10 Nentor 2016).

Krahas arritjeve, Komunitet rinore jane perballur dhe me **sfida** te cilat kane qene kujdesi ndaj 2 te rinjve te cilet shfaqin veshtiresi dhe crregullime emocionale dhe te sjelljes te cilet jane mbeshtetur dhe ndjekur me sherbime te specializuara prane mjekut psikiater ne QSUT. Ndjekja ne vazhdimesi e ktyre rasteve perben sfide te punes ne vazhdimesi per Komunitet rinore.

4.3 Arritjet kryesore te 2016, praktikat e mira dhe sfidat ne FSP

FSP SAUK

Projekti Fuqizimi i Familjes Sauk ka nje eksperience 10-vjeçare ne ofrimin e sherbimeve per familjet ne nevoje dhe vit pas viti sherbimet per femijet/te rinjte dhe familjet kane ardhur duke u permiresuar. Komuniteti dhe partneret ne zonat ku operojme njohin target-grupin dhe sherbimet qe projekti yne ofron. Kerkesat ne rritje te familjeve te cilat kerkojne mbeshtetje si dhe ardhja e tyre nga zona te cilat nuk mbulohehen nga projektet parashtrone nevojten per zgjerim dhe rritje ne numer te projekteve te Fuqizimit të Familjes ne zona te tjera. Projekti ka mbeshtetur ne total 72 familje me 189 femije nga te cilat 30 familje me 77 femije jane larguar si te sukseshme ndersa 25 familje me 62 femije te cilat jane pjese e target grupit tone jane bere pjese e projektit.

Sherbimet qe ofron FSP Sauk:

Shërbimi pediatrik: ofrohet per te mbuluar nevojat e projektit nepermjet kontroleve mjekësore, seancave te këshillimit në grup dhe individuale 50% e femijeve të projektit kanë përmirësuar kujdesin shëndetësor përmes ilaceve, analizave, vizitave diagnostikuese. **Shërbimi edukativ** është një nga shërbimet më të frekuentuara nga fëmijët në nivel programi duke i mbështetur ata me seanca pas shkolle për të kaluar vështirësitë. 98 % e femije te cilet jane ne grupmoshe per arsimin e detyrueshem frekuentojne ne menyre te rregullt. 87 femije te projektit jane mbeshtetur me paketa shkollore per vitin e ri akademik 2016-2017.

Shërbim psikologjik për fëmijë dhe të rritur: Rreth 45 % e fëmijëve të projektit kanë përmirësuar mirëqënien e tyre psikosociale përmes seancave individuale/grup si dhe nepermjet aktiviteteve te organizuara. Grupet vetë-ndihmëse kanë funksionuar rregullisht nëpërmjet Klubeve të Nënave dhe Baballarëve. Qëllimi ynë është të përfshijmë në këto grupe kujdestarë nga komuniteti lokal me qëllim fuqizimin e rrjetit në komunitet.

Shërbimet ligjore ofrohen falas nga Shërbimi i Ndhmës Ligjore TLAS i cili është partneri ynë kryesor për çeshtjet ligjore

Sherbimi logopedik Gjate kesaj periudhe 12 femije jane ndjekur me mbeshtetje logopedie dhe kanë përmirësimit në të folur dhe kanë një ecuri më të mirë në sjellje.

Shërbimet për aktivitetet ne përmirësimin e kushteve të jetesës dhe pako ushqimore. 20 familje jane mbeshtetur per permiresimin e kushteve te jeteses duke e bere te sigurte jetesen e femijeve. Familjet janë fuqizuar nepermjet mbeshtetjes nga donacionet e perfitura nga individe te ndryshem si (divane, frigorifer, lavatriçe, batanije, jorgane, ene guzhine dhe riparime te pjesshme shtepie, pako ushqimore.

Ngritja e kapaciteteve prinderore, pergjate vitit 2016. 65 % e prinderve kane rritur kapacitetet permes trajnimeve / seminareve / ëorkshopeve / te organizuara ne grupin e vetndihmes, klubin e baballareve dhe aktiviteteve psikosociale. Temat e trajnimeve kane qene a) Metodot e Planifikimit Familjar b) Punesimi c) Politika e mbrojtjes se Femijeve d) format e dhunes dhe te abuzimit. Ne **muajin Dhjetor Fsp Sauk** ka filluar implementimin e trajnimit te **SFP**. Deri tani jane organizuar 4 sesione trajnimi dhe eshte vene re qe perfituesit kane nje interesim te madh per tematikat qe trajtohen. Keto vitet e fundit punonjesit e CPU dhe administratoret sociale jane ndryshuar shpesh dhe neve na eshte dashur te rrisim kapacitetet e tyre me informacione te vazhdueshme per sherbimet qe ne ofrojme dhe ne disa raste edhe per vendndodhjen e familjeve.

Advokasi .FSP Sauk ka advokuar per regjistrimin e 4 femijeve ne kopesht pasi kishin pengesa burokratike per tu regjistruar, per perfitimin e ndihmes ekonomike per 4 familje dhe perfitimin e statusit te jetimi per 1 femije, referim/lobim tek njesia administrative per perfitimin e bonusit te qerese dhe banese sociale per 30 familje te reja te projektit. Transferim dokumentash ligjore per ndryshim vendbanimi per 3 familje, Advokim per te drejtat e femijeve ne komunitetin, nepermjet Fushates Sensibilizuese per te drejtat e femijeve. Shpërndarja e fletëpalosjeve, posterave ne bashkepunim me Agjensine Shtetore per Mbrojtjen e te Drejtave te femijeve ne kuader te javes per te Drejtat e Femijeve.

Monitorimi dhe Vleresimi: Database, Monitorim financiar I projektit, Vetevleresimi I Projektit I cili behet nje here ne vit ne muajin Shtator, Cdo vit radhasi ne nivel Programi monitorojme aksionet e ndermarra per plotiken e mbrojtjes se femijeve.

Praktikat kryesore pozitive të FSP Sauk për vitin 2016 që mund të përmendim janë: Grupi i vetendihmes, Moduli i Trajnimit te SFP, Database, Kurset profesionale.

Sfidat

- Aplikimi tek organizata te huaja apo institucione shtetore per fonde shtese .
- Ngarkesa e rasteve per punonjes dhe nevoja punonjes shtese.
- Hedhja e te dhenave ne database dhe plotesimi i dokumentacionit me informacione te njejta per familjet eshte ngarkese dhe dublikim informacioni.
- Ofrimi i punëve të papërshtatshme nga zyrat e punës për prindërit ka cuar në heqjen e ndihmës ekonomike dhe uljen e të ardhurave minimale në familje, duke thelluar pragun e varfërisë.
- Pagesat e ulëta nga fasoneritë për nënat të cilat janë punësuar nëpërmjet zyrave të punës dhe mungesa e qëndrueshmërisë së punësimit për targetin që ne mbështesim.
- Ndryshimi i administratoreve tek Njesia Bashkiake ku ne operojme ka qene sfide per ne sepse brenda 2016 jane ndryshuar 2 here administratoret lokale.

FSP DON BOSKO

Në fund të Vitit 2016 janë mbështetur nga projekti 67 familje, 118 adult 8 young adult dhe 180 fëmije. Në fillim të vitit numri I fëmijëve është ulur (me 16 fëmijë) duke lehtësuar ngarkesën e punonjësve socialë dhe duke rritur cilësinë e shërbimeve. Janë investiguar 60 familje dhe janë bërë pjesë e projektit 14 familje, ndërkohë kanë dalë 22 familje, 21 familje të sukseshme dhe 1 familje për arsye të tjera. Nuk ka ndryshime të target grupit.

Shërbimi edukativ: 50 fëmijë janë mbështetur rregullisht nga shërbimi edukativ. 45 fëmijë janë mbështetur me transport për të frekuentuar institucionet arsimore, 130 fëmijë kanë marrë paketa shkollore.

Shërbimi i Psikologut. Psikologjia për të rritur ka bërë vlerësimin e 14 familjeve të reja që janë bërë pjesë e projektit për 2016 dhe ka zhvilluar seanca këshillimi me 50 raste. 70% e te rriturve kane përmirësuar stilin e tyre të prindërimit dhe komunikimin në familje dhe ndihen më mirë emocionalisht. Psikologjia për fëmijë ka bërë vlerësimin e 30 fëmijëve që janë bërë pjesë e projektit këtë vit, ka organizuar trajnime, focus grupe ku 60% e femijeve kanë rritur vetëbesimin dhe kanë zbutur problemet emocionale.

Shërbimi i Peditres. ofrohet nepermjet kontrolleve mjekësore, seancave te këshillimit në grup dhe individuale 80% e fëmijëve dhe 70% e të rriturve që kanë pasur probleme shëndetësore janë mbështetur me medikamente dhe kanë përmirësuar situatën e tyre shëndetësore.

Shërbimi i Logopedisë. Ky shërbim është në vitin e dytë të implementimit dhe ofrohet për 7 fëmijë. Përmes terapeve logopedike të shtatë fëmijët kanë korrigjuar defektet e shqiptimit.

Lojërat Verore. Në muajin Qershor-Korrik në bashkëpunim me Qendrën Sociale Don Bosko u zhvillua kampi veror “Edelon” ku morën pjesë 20 fëmijë. Në muajin Shtator 25 fëmijë të projektit morrën pjesë në kampin e Gjinarit të organizuar nga Bashkia me SHKEJ. Këto aktivitete kanë ndikuar në lehtësimin e buxhetit.

Mbështetja e familjeve. Janë kaluar 10 transferta mujore, ku familjet janë mbështetur sipas nevojave të tyre të përcaktuara në bashkëpunim me punonjësit socialë. Këtë vit është ndërmjetësuar për punësimin e 16 të

rriturve dhe janë punësuar 8 të rritur pranë EKO Tirana. 10 nëna janë certifikuar nga Kryqi I Kuq Shqiptar në kursin e kuzhinës. Kurset kanë ndikuar në lehtësimin e buxhetit.

Advokim. Eshtë advokuar për rregjistrimin e 12 fëmijëve në kopsht dhe cerdhe. Eshtë advokuar për 30 fëmijë të komunitetit egjiptian për përfitimin e tekseve shkollore falas.

Aktivite per të drejtat e femijeve: Trajnim me temë "Si të stopojmë bulizimin" në kuadër të PMF. Trajnim me temë: Si të përmirësojme komunikimin me bashkëmoshataret tanë" Aktivitetet për zbulimin e ambienteve të Qendrës me fëmijët, që kanë talente të ndryshme. Minikampionati I organizuar mes fëmijëve të Projektit FF, Qendrës Sociale Don Bosko, SHKEJ, dhe Save the Children. Pjesëmarrje në aktivitetin sensibilizues në Ditën Ndërkombëtare kundër punës së fëmijëve. Pjesëmarrje aktive në aktivitetet e javës së të drejtave 14-20 Nëntor. 10 të rinj kanë marrë pjesë në aktivitetin e organizuar nga UNFPA kundër trafikimit " Mos I thjeni ëndrrat e saj" . Aktivite informuese dhe argëtuese janë organizuar; për festat e Nëntorit, Halloëeen, Vitit të Ri.

Risi dhe Praktika positive. Në muajin Nëntor filloi zbatimi I programit **SFP**. Në këtë program ishin pjesëmarrës 12 të rritur dhe 18 fëmijë. Zbatimi I projektit ishte eksperiencë pozitive edhe për stafin për rritjen e tyre profesionale. Këtë vit Këshilltaria Nacionale e FSP ndau si praktikë pozitive me kolegë të FSP-ve të tjera punën dhe rezultatet e arritura në Klubin e Baballarëve si një shërbim unik që projekti ofron.

Takimet me partnerët. Bashkëpunimi me partnerët tashmë është I qëndrueshëm dhe rolet në takimet e planifikimeve të përbashkëta janë të mirëpërcaktuara

Vlerësim dhe monitorim Supervizimet e stafit janë realizuar rregullisht. Database është përdorur nga stafi për monitorim dhe vlerësim të familjeve në nivel projekti.

Sfidat Situata e paqëndrueshme ekonomike dhe sfidat e biznesit vendas kanë ndikuar në uljen e dhurimit të donacioneve për shtresat në nevojë. Përbalja me familje të riatdhesuara, të cilat në momentin që kthehen nuk kanë as shtëpi, as punë, dhe fëmijet janë të shpëputur nga shkollat. Ndryshimet e shpeshta në sistemin e Database.

Zhvillimi i stafeve të FSP gjatë vitit 2016 : a) trajnimin 2 ditor për SFP (strengthening family program) b) Sesion Informimi për ngritjen e fondeve c) Kordinatori I projektit ka marrë pjesë " Menaxhimi i Riskut" d) Supervizimet mujore në grup.

5. Programi i Fuqizimit të Familjes Shkodër

SOS Shkodra funksionon si njësi e Programit të Fshatit të Fëmijëve që nga janari i vitit 2015. Bazuar në drejtimet strategjike të CVPP, lokacioni i Shkodrës ka fokusuar aktivitetin e saj në (i) forcimin dhe rritjen e aftësive të prindërve për të promovuar zhvillimin optimal të fëmijës (ii) advokasi dhe mbrojtje të fëmijëve) Kujdes alternativ. Target grupi përfshin (i) fëmijë në rrezik për humbje të kujdesit prindëror (ii) fëmijët në proces riintegrimi nga institucionet e kujdesit social në familjet biologjike ose në familjen e zgjeruar (iii) fëmijët që jetojnë në familjet kujdestare / familjare

Në fund të vitit 2016 projekti mbështeti 326 fëmijë (305 fëmijë / 21 të rinj) dhe 139 familje. Çështjet kyçe me të cilat përballeshin familjet ishin ushqimi i dobët, strehimi i varfër, mungesa e kujdesit mjekësor parandalues, të ardhura të ulëta, më pak gjasa për të ndjekur shkollën, papunësia, përvoja e jetesës në institucionet e kujdesit social etj.

Në partneritet me Save the Children dhe Bashkinë e Shkodrës, ne kemi zbatuar projektin "Përmirësimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri", i cili kishte për qëllim fuqizimin e shërbimeve sociale në mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve të privuar ose në rrezik të humbjes së kujdesit prindëror në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe Kujdes alternativ.

Në kuadër të fushatës "Zëri i të rinjve - e ardhmja që duam", UNFPA mbështeti një ekip të të rinjve SOS në mënyrë që (1) të rrisë kapacitetet e avokimit të të rinjve; (2) të fuqizojë angazhimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitetet e komunitetit (3) të forcojë angazhimin e të rinjve në të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, qëndrueshmërinë, udhëheqjen, pjesëmarrjen, riprodhimin shëndetësor, vullnetarizmin.

Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve ka udhëhequr punën me fëmijët / familjet e Shkodrës gjatë vitit 2016. Aktivitetet në nivel programi për përfituesit, bashkëpunimi me autoritetet lokale dhe me organizata të ndryshme kanë pasur për qëllim (i) përmirësimin e kujdesit cilësor të fëmijëve (ii) mbështetjen e fëmijëve në kujdes alternativë (lii) zhvillimin e fushatave të ndërgjegjësimit të komunitetit (iv) rritjen e kapacitetit të prindërve dhe stafit që punojnë me fëmijët.

Gjatë vitit 2016 roli i qeverisjes vendore është rritur ndjeshëm. Marrëveshja dypalëshe me Bashkinë është shqyrtuar dhe është në proces të nënshkrimit. SOS Shkodra ishte anëtare e grupit të të punës për zhvillimin e Planit Social të Shkodrës, është anëtar i Planit të Veprimit të Pushtetit Lokal për Mbrojtjen e Fëmijëve Rruga. Stafi ka qenë pjesë e grupeve të monitorimit në terren, për të parandaluar fëmijët e rrugës nga fenomeni i shfrytëzimit dhe lypjes. Është krijuar një bashkëpunim i mirë me institucionin publik të kujdesit social 6-18

vjeç. Është duke u zbatuar një Plan Veprimi për De-I që synon të rivendosë lidhjen midis fëmijëve dhe familjeve në një ambient të qetë dhe të sigurt përpara integritet të tyre. Analiza e palëve të interesuara rifreskohet në qershor 2016. Organizatat partnere të tilla si Eorld Vision, UNDP dhe Diaconia International Aid kanë mbështetur procesin e fuqizimit të familjeve në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, punësimit, përmirësimit të standardeve të largimit.

Dukshmëria e organizatës ka qenë e ndjeshme në komunitet përmes pjesëmarrjes në panairë lokale dhe kombëtare, aktiviteteve të avokimit, pjesëmarrjes në programet televizive dhe radio.

Aktivitetet dhe shërbimet e FSP Shkodër

Për shkak të ndarjes së re territoriale, FSP realizoi aktivitetet e saj në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë së Shkodrës. 4 punonjës social me orar të plotë dhe 5 specialistë me kohë të pjesshme (2 psikologë, një asistent arsimor, një animator dhe një këshilltar ligjor) ofruan shërbime të bazuara në Procedurën e Menaxhimit të Rasteve.

139 familje ose 326 fëmijë janë mbështetur përmes një sërë shërbimesh të përshtatura për nevojat e tyre, duke iu qasur shërbimeve publike parashkollore si një e drejtë themelore për arsim, mirëqenie, integritet të familjeve në jetën shoqërore përmes trajnimeve të aftësive jetësore, takimeve, aktiviteteve psiko-sociale, të ardhurave Mbështetje të gjeneratës.

Gjatë gjithë vitit, 57 fëmijë konsiderohen të vetë mbështetura dhe janë larguar me sukses nga projekti dhe 51 fëmijë të tjerë iu bashkuan projektit në përputhje me kriteret e pranimit. Procedura e Menaxhimit të Rastit përdoret si mjet themelor gjatë punës sociale me familjet.

58 fëmijë (31 familje) konsiderohen të vetë mbështetura dhe pa rrezik që të braktisen nga familjet e tyre. 1 i ri ka forcuar ndjenjën pozitive ndaj vetes dhe e ka lënë projektin me sukses, 53 kujdesdhënës përmirësuan njohuritë dhe aftësitë e tyre prindërore.

15 fëmijë (7 familje) dhe 14 kujdesdhënës iu bashkuan projektit në përputhje me kriteret e pranimit dhe procedurën e MR.

Çdo punonjës social ka menaxhuar 23-25 raste familjesh (ose 80-83 fëmijë). Nevojat e fëmijëve / familjeve të vlerësuara nga punëtorët e rasteve janë pasqyruar në Planin e Zhvillimit të Familjes.

Shërbimi shëndetësor ka siguruar cilësi të kujdesit shëndetësor, parandalimin e problemeve të shëndetit dhe medikamente (për 120 fëmijë dhe 37 prindër), kujdes dentar (2 fëmijë), vizita tek okulisti (6 fëmijë) vizita diagnostikuese (6 fëmijë).

Mbështetja edukative ka rritur barazinë në mundësitë për zhvillim të arsimit përmes mbështetjes pas shkolle (20 fëmijë), furnizimeve shkollore (38 fëmijë), qendrave të kujdesit ditor dhe kopshteve (36 fëmijë).

Dy psikologë mbështetën nevojat psiko-emocionale të fëmijëve dhe prindërve dhe një animator ofroi argëtim për për fëmijët dhe aktivitete të integritet social.

Sistemi i bazës së të dhënave përditësohet dy herë në vit me shërbimet e ofruara për fëmijët dhe kujdestarët dhe përdoret si mjet monitorimi statistikor për analizimin e të dhënave të regjistruara.

Këshilltari ligjor mbështeti 8 fëmijë për regjistrim që nga lindja, statusi martesor, arsimit dhe strehimi.

Personeli i rriti kapacitetet e tyre përmes trajnimeve të organizuara nga Save the Children për "Disiplinën pozitive", "Alternative Care", "Komunikimi me Fëmijët", Eorld Vision "Familja Familjare", Terre des Hommes "Puna ndërsektorale për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri".

Praktikat pozitive

Forcimi i sistemit të referimit me Shërbimin Social të Bashkisë ka përmirësuar përfshirjen e strukturave lokale në ndërhyrje konkrete për familjet. .

Ndërveprimi i projekteve brenda programit ka rritur dukshmërinë e organizatës dhe ka konsoliduar pozicionin e saj si ofrues i shërbimeve për fëmijët në rrezik të humbjes së kujdesit prindëror ose pa kujdes prindëror.

Krijimi i modeleve / shembujve pozitivë të familjeve të fuqizuara ka inkurajuar familjet e tjera për të përmirësuar jetesën e tyre. Punësimi i një nëne egjiptiane inkurajoi tre nëna të tjera për t'u punësuar.

Projekti i Zërit të Rinisë

Në kuadër të fushatës globale "Zëri i Rinisë - E ardhmja që duam", një Ekip i themeluar i të rinjve zbatoi një Plan Veprimi gjatë periudhës korrik-dhjetor 2016. Aktivitetet synonin fuqizimin dhe rritjen e kapaciteteve të të rinjve në avokim, pjesëmarrje dhe edukimin e bashkëmoshatarëve nëpërmjet trajnimeve, seminareve dhe aktiviteteve shoqërore. Një takim i hapur u organizua me kryetaren e Bashkisë për të diskutuar mbi masat që qeveria lokale po ndërmerr për të rinjtë. Një udhëheqës i të rinjve SOS mori përgjegjësinë për të organizuar dy seminare me ekipin rinor të SOS për shëndetin riprodhues dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme. Institucionet lokale si Bashkia, Departamenti i Shëndetit Publik dhe Drejtoria Arsimore Rajonale ishin fokusi i adresimit të çështjeve që kanë të bëjnë me të rinjtë.

Praktikat e mira dhe mësimet e nxjerra

Të rinjtë dëgjohen dhe merren seriozisht dhe janë pjesë e një ekipi dinamik të përkushtuar për përmirësimin e shërbimeve të kujdesit lokal për të rinjtë. Një delegacion prej 7 vetash u mirëprit nga kryetarja e bashkisë në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, i cili u përgjigj shqetësimeve të të rinjve dhe diskutoi mbi projektet e Bashkisë për të rinjtë. Ngjarja u shfaq / u mbulua nga të gjitha mediat lokale.

Të rinjtë janë të fuqizuar sa duhet për të mbrojtur shkaqet që prekin drejtpërsëdrejti të drejtat e tyre.

"Përmirësimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri"

Projekti filloi më 1 mars 2016 në bazë të një bashkëpunimi trepalësh midis Save the Children, SOS Fshati i Fëmijëve në Shqipëri dhe Bashkia Shkodër.

Me specialistin e departamentit të shërbimeve sociale të Bashkisë së Shkodrës është kthyer një marrëdhënie e fortë për zbatimin e Procedurës së Menaxhimit të Rasteve për fëmijët e pranuar në projekt.

Projekti ka përfshirë 54 fëmijë FS (23 familje). Për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve dhe shërbimeve të tjera plotësuese, përfituesit e projektit pranohen edhe në projektin FS. 6 raste janë referuar nga Shërbimi Social dhe NJMF ndërsa 3 raste të tjera janë referuar nga institucioni i kujdesit social 3-6 vjeç dhe 6-18 vjeç të cilat janë në proces të kujdestarisë.

Numri i rasteve të referuara nga Shërbimet Sociale të Komunës është rritur dhe veprime konkrete janë ndërmarrë në bashkëpunim me ta.

Është e nevojshme të theksohet se të gjitha rastet e referuara në procesin e kujdesit fisnor zhvillohen me hapa të ulëta. Gjatë procesit të riintegrit të fëmijëve, prindërit kujdestarë duhet të marrin një program orientimi, me qëllim që të rrisin aftësitë dhe njohuritë e tyre për rolin e tyre prindëror.

Histori suksesi

Një e ardhme plot shpresë

"Unë jam në klasën e dytë këtë vit dhe po shkoj shumë mirë" thotë Ildo, i lumtur për suksesin e tij. - Dua të bëhem polic kur të rritem kështu që më duhet të studiojë. Kam edhe një mësuese që më ndihmon pas shkollë" "Unë dua të bëhem një futbollist i famshëm dhe stërvitem 3 herë në javë por përsëri në shkollë duhet të mësoj" thotë vëllai i tij Emilio me entuziazëm ndërsa une po bëja një bisedë të vogël me ta.

Ildo, Emilio dhe familja e tyre erdhën në kryeqytet nga një zonë shumë e varfër e Shqipërisë. Në atë kohë ishin të keqshqyer dhe të veshur si mos më keq. Babai është i paaftë për punë për shkak të një problem shëndetësor me sytë (ai nuk mund të shoh kur errësohet) dhe për nënën gjetja e një pune ishte e pamundur. Strehimi i fëmijëve bëhej i pasigurt sepse ata nuk mund të paguanin dot qiranë, le pastaj t'i arsimonin apo tu shkonte nëpër mend që fëmijët kishin ëndrra.

Situata ndryshoi plotësisht kur familja u bë pjesë e projektit të fuqizimit të familjes në SOS. Me ndërhyrjen e menjëhershme të stafit, familja gjeti rrugën e saj dhe për herë të parë filloi të jetonte siç meriton çdo qenie njerëzore. Babai tani merr ndihmën sociale që l takon dhe me vullnetin e tyre të mirë, stafi i FSP-së l gjeti një punë dhe nënës.

"dëshira për të parë përpara dhe për të mos hequr dorë, më bënë mua dhe familjen time ta shohim jetën në një tjetër këndvështrim. Tani kemi besim në vetvete dhe jemi gati të punojmë bashkë për 3 fëmijët tanë" ishin fjalët e babait që na bënte të ditur se familja është shtuar edhe me një anëtarë.

Ildo dhe Emilio (dhe tani dhe vëllai i tyre) janë mes 751 fëmijëve të cilët jetojnë në komunitetet përreth Tiranës. Me mbështetjen e donatorëve të SOS-it, jeta e tyre ka ndryshuar sepse ata shkojnë në shkollë, luajnë si çdo fëmijë, bëjnë aktivitete dhe mund të shprehin dëshirat e tyre për të ardhmen.